



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministerstvo zdravstva - Ministry of Health**  
**Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division**

Prishtine datë, 27.02.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.02.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Goldberg Industries L.L.C. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ri-tender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS”-2 me numër prokurimi 206-25-127-2-1-1, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Pranohet**, si pjesërisht e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Goldberg Industries L.L.C. e dt. 21.02.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ri-tender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS”-2 me numër prokurimi 206-25-127-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 16.01.2025;
2. Anulohet Njoftimi për Kontratë të datës 16.01.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos ta anuloj, korrigjoj, pastaj ta ritenderoj aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik Goldberg Industries L.L.C. me datën 21.02.2025, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ri-tender “Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit BHIS”-2 me numër prokurimi 206-25-127-2-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 26.02.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:**

1. Neni 7 i LPP-së
2. Neni 28 i LPP-së
2. Neni 8 i LPP-së
3. Neni 9 i LPP-së.

### Pretendimet ankimore te OE ankues:

1. Tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional, specifikisht tek Kërkesa 1, AK kërkon si në vijim: "Operatori Ekonomik duhet të ofrojë prova se ka realizuar të paktën një projekt të zhvillimit, implementimit ose mirëmbajtjes së sistemeve në fushën e shëndetësisë për një nga institucionet shëndetësore, gjatë tre viteve të fundit, duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë."

Gjatë hartimit të DT, AK duhej të merrte parasysh, duke filluar nga vetë pozicioni i tij si institucion përgjegjës, se sistemet shëndetësore, qoftë në sektorin publik apo privat, nuk janë me mandat 3 vjeçar. Rrjedhimisht kërkesa për tre vite është e palogjikshme.

Duke ndjekur këtë qasje, AK-ja ka vendosur kushte që kufizojnë konkurrencën, gjë që bie ndesh me Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Për të shmangur këtë kufizim dhe për të garantuar një proces të hapur dhe të drejtë mes operatorëve ekonomikë, AK-ja do të duhej të pranonte si të vlefshme edhe dëshmitë ose referencat për projekte të zbatuara brenda një periudhe më të arsyeshme, e jo ta kufizoj atë vetëm në 3 vite.

Përndryshe, përveç me Nenin 7 të LPP-së, kjo kërkesë bie në kundërshtim edhe me nenin 28 të LPP-së.

2. AK ka parashikuar vlerën e projektit në shumën ekuivalente prej 432,000.00 Euro, për një kohëzgjatje prej 36 muajsh. Ndër të tjerash, ka kërkuar angazhimin e 13 eksperteve.

Pra, me një projekt me aq vlerë të vogël dhe volum të masdh të punë, me kohëzgjatje të gjatë në njërin anë, ndërsa në anën tjetër me kërkesë për 13 (trembëdhjetë) eksperteve nga rradhët e personelit ku për asnjërin nuk është caktuar kohëzgjatja e angazhimit, nuk janë caktuar punët dhe vëllimi i tyre për përmbushjen e kërkesave të përshkruara në Aneksin 1 të DT, ekziston dyshimi i lartë që nuk janë marrë parasysh detyrimet ligjore që rrjedhin nga dispozitat ligjore të Nenit 8 dhe 9 të LPP-së. Kjo për faktin se, duke marrë parasysh përgatitjen profesionale të kërkuar për stafin, vëllimin e punëve të përshkruara në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, si dhe pagat në tregun e Kosovës, kostoja për implementimin e këtij projekti është të paktën tre herë më e lartë se vlera e parashikuar, pa llogaritur fitimin e kompanisë dhe tatimet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

AK vlerësimin do të duhej ta bënte bazuar në kushtet e tregut – por megjithatë AK me një kërkim të thjeshtë në ATK mund ta shoh se paga minimale për cilindo prej personelit që ka kërkuar është mbi 2,500.00EUR. Pra, MINIMALJA. Po ashtu, para tenderimit të këtij aktiviteti do të duhej ta bënte vlerësimin në bazë të kapaciteteve buxhetore të AK-së.

Kapacitet buxhetore do të duhej të merreshin parasysh në dy sfone; Sfondi i parë: kapaciteti buxhetor i AK-së për vitin 2025 është dukshëm më i madh ekuivalent me 83.4 milion në krahasim me tenderin e njëjtë të vitit 2022, ku AK kishte buxhet prej 52.7milion.

7. Bazuar në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit, konkretisht "Ndryshimet në system (Aplikacion dhe Database)", AK kërkuar çdo ndryshim ose përmirësim duhet të realizohet pa kosto shtesë gjatë periudhës së mirëmbajtjes.

Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili detyron Autoritetin Kontraktues të hartojë specifikime teknike të sakta, të qarta dhe të mirëdefinuara, duke siguruar qasje të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe duke shmangur vendosjen e kushteve që mund të jenë diskriminuese apo të paqarta.

Në këtë rast, AK nuk ka përcaktuar qartë se çfarë përfshihet në konceptin e "ndryshimeve" dhe "përmirësimeve", duke krijuar pasiguri për ofertuesit lidhur me përmasën dhe kompleksitetin e këtyre kërkesave. Për më tepër, kërkesa që çdo ndryshim apo përmirësim të realizohet "pa kosto shtesë" është e paqartë dhe e pajustificuar ekonomikisht, pasi një ndryshim në sistem mund të variojë nga një rregullim i vogël deri te një zhvillim madhor që kërkon burime të konsiderueshme.

Një specifikim i tillë krijon paqartësi juridike dhe ekonomike për operatorët ekonomikë, të cilët mund të hezitojnë të marrin pjesë në tender për shkak të detyrimeve të papërcaktuara qartë, duke reduktuar konkurrencën dhe duke vënë në dyshim ligjshmërinë dhe transparencën e procesit të prokurimit.

Sidomos, hezitimi vie në pah edhe më shumë kur marrim parasyshë vlerën e vogël dhe të paarsyeshme të këtij aktiviteti të prokurimit. Për rrjedhojë, kjo kërkesë duhet të riformulohet në mënyrë që të jetë e përcaktuar saktësisht dhe në përputhje me parimet e ligjit, duke siguruar kushte të qarta dhe të ekuilibruara për të gjithë pjesëmarrësit në procesin e prokurimit.

**Dëmet materiale:** Demet materiale janë rreth 5,000.00 Euro

### Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet ankimore

AK-MSh i ka shqyrtuar pretendimet e juaja ankimore dhe bazuar ne permbajtjen e tyre mund te konstatojme se disa prej tyre jane te pa bazuara dhe disa pjeserisht te bazuara.

- Ne lidhje me pretendimin rreth referencave ne tre vitet e fundit dhe mundesise per marrjen parasysh te referencave me afat me te gjate, per implementimin dhe mirëmbajtjen sistemit te njëjtë, ky pretendim eshte i pa bazuar, meqense kerkesa eshte ligjore dhe rrejedh nga dispozita e sakt, referuar A02 Udhezuesit Nr. 001-2023 per prokurim, ku specifikohet si ne vijim:

#### 3. Aftësitë teknike dhe/ose profesionale

Në rast të kontratës për furnizim të produkteve:

b) Vlera minimale në lidhje me shërbimet në 3 vitet e fundit

Ne ju sqarojmë se me këtë projekt për AK-MSh është e nevojshme qe krahas mirëmbajtjes te behet edhe avancimi i sistemit ekzistues. Për avancimin e sistemit ekzistues, te pika 2 e ToR – “Shërbimet e kërkuara për mirëmbajtje dhe avancim” njëra nga pikat është upgrade te teknologjive qe janë përdorur ne zhvillim te aplikacionit ne teknologjitë me te reja.

Pas shqyrtimit te ToR ne si AK e kemi vërejtur se kjo pike e upgrade te teknologjive nuk është e detajuar sa duhet dhe është e nevojshme te plotësohet me përmbajtje me te detajuar te komponentëve dhe modaliteteve te funksionimit, andaj duke e ditur rëndësinë e projektit dhe me qellim te realizimit sa me te suksesshëm te këtij projekti, e konsiderojmë se zgjidhja me e drejte është anulimi dhe ri tenderimi i këtij aktiviteti, pasi te behet përmirësimi i ToR.

- Në lidhje me pretendimin rreth stafit të kërkuar në Raport me shumën e projektit, konsiderojmë se ky pretendim është pjesërisht i bazuar dhe kjo kërkesë do të jetë subjekt i trajtimit gjatë shqyrtimit të specifikave para se të ri-tenderohet.
- Në lidhje me pretendimin nga pika 3, konsiderojmë qe ky pretendim është pjesërisht i bazuar, për shkak se kontrata është 3 vjeçare dhe gjate kësaj periudhe kohore mund te shfaqet nevoja e ndonjë ndryshim qe nuk eshte parapare me herët, si psh ne rast te ndryshimeve ne ligj ose UA i cili do te integrohet ne sistem, apo për ndonjë arsye tjetër. Andaj kjo kërkesë do të jetë subjekt i trajtimit gjatë shqyrtimit të specifikave para se të ri-tenderohet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

### Vendimi i dorëzohet:

1. OE Goldberg Industries L.L.C.
3. Operatorëve ekonomik te interesuar.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit